

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Ditët e Transparencës

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka filluar zbatimin e projektit “Ditët e Transparencës”, në 12 bashkitë qendër Qarku.

Gjatë zbatimit të këtij projekti, Zyra e Komisionerit do të zhvillojë takime me titullarët e autoriteteve publike, koordinatorët për të drejtën e informimit, përfaqësues të shoqërisë civile dhe median.

Qëllimi kryesor i projektit është garantimi i të drejtës për akses në informacion publik, duke ndikuar në konsolidimin e një administrate dinamike dhe transparente.

Pjesë e takimeve do të jetë diskutimi mbi rëndësinë e transparencës proaktive të autoriteteve publike, elementë kyç i antikorrupsionit dhe mirëqeverisjes; diskutimi i praktikave më të mira në zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit si dhe vështirësitë e hasura nga përfaqësuesit e administratës publike për garantimin e kësaj të drejte. Një hapësirë e veçantë do ti kushtohet dëgjësës së çështjeve të raportuara nga shoqëria civile në lidhje me vështirësitë dhe problematikat e konstatuara.

Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

Vendim nr. 1 - Banka e Shqipërisë

Vendim nr. 2 - Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

28 Rekomandime ndaj Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit dhe Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË NJË NGA SHTYLLAT
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit shkurt 2022, ka dhënë 2 vendime urdhërimi në zbatim të ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit” dhe 28 rekomandime.

Me anë të vendimit nr.1, datë 10.02.2022, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj “Bankës së Shqipërisë (Autoriteti Publik), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit nëpërmjet e-mail-it datë 09.12.2021, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, si më poshtë:

1. Shpenzimet e Autoritetit Publik për njoftimet në shtyp, media online ose gazeta, për njoftime tenderash apo ankandesh për periudhën Janar 2020 - Dhjetor 2021.

2. Emrat e mediave të përzgjedhura për këtë shërbim dhe kriteret e përzgjedhjes, nëse ka.

Autoriteti Publik, me e-mail e datës 22.12.2021 ka kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion duke sqaruar se: “...Informacioni i kërkuar është i një natyre sensitive dhe të dhënat në përmbajtje të tij janë informacion jo publik i klasifikuar “sekret bankar/profesional”.

Ankuesi, pas përgjigjes së sipërcituar, pretendon se informacioni i kërkuar nuk përbën sekret bankar dhe kërkon nga Zyra e Komisionerit ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së dokumentacionit nga autoriteti publik.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore. Zyra e Komisionerit, kërkoi qëndrimin e Autoritetit Publik sa i përket pretendimit të ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar. Autoriteti Publik në përgjigje të kërkesës së Zyrës së Komisionerit sqaroi se “...Publikimi i njoftimeve për tendera rregullohet në nenin 13 të rregullores “Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr. 81, datë 15.11.2006 i ndryshuar. Rregullorja është e publikuar dhe transparente për publikun në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.”

Pas konsultimit të legjisllacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar,

Komisioneri vlerëson se argumentet e paraqitura nga Autoriteti Publik për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndrojnë.

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, sipas së cilit: “Informacioni i kërkuar është i një natyre sensitive dhe të dhënat në përmbajtje të tij janë informacion jo publik i klasifikuar “sekret bankar/profesional”, Komisioneri vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron, pasi terminologjia “Sekret Bankar” e përdorur nga Autoriteti Publik nuk gjen rregullim të posaçëm në Ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në gjithë kuadrin nënligjor të dalë në zbatim të tij.

Sa i përket argumentit të Autoritetit Publik lidhur me: “...Publikimi i njoftimeve për tendera rregullohet në nenin 13 të rregullores “Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr. 81, datë 15.11.2006 i ndryshuar”, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Objekti i kërkesës për informacion nuk përputhet me përgjigjen e kthyer, e cila referon procedurën që ndiqet lidhur me shpalljen e njoftimit për tender, por lidhet konkretisht me shpenzimet që kryen ky Autoritet Publik sa i përket njoftimeve për shtyp, media online etj.

Në nenin 2 të Rregullores së sipërcituar parashikohen parimet kryesore mbi bazën e të cilave kryhen procedurat e prokurimit nga Autoriteti Publik. Në pikën “d” të këtij neni parashikohet parimi i sigurimit të ndershmërisë, besimit të publikut dhe të arritjes së transparencës në procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë”.

Gjithashtu, në asnjë dispozitë të Rregullores nuk parashikohet klasifikimi si sekret bankar i informacionit të kërkuar në kërkesën e depozituar nga ankuesi pranë Autoritetit Publik.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni administrohet nga Autoriteti Publik dhe ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Në përfundim të procesit administrativ, KDIMDP vendosi urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit të kërkuar. Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.

Transparenca proaktive e Autoriteteve Publike, përmbushje të detyrimeve për forcimin e llogaridhënies



Programi i Transparençës dhe Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve janë nga elementët e rëndësishëm të transparencës proaktive dhe tregues i përgjegjshmërisë e llogaridhënies së Autoriteteve Publike. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zhvilloi një takim me koordinatorë të institucioneve qendrore e të varësisë dhe atyre të pavaruara, ku paraqiti problematikat e konstatuara në Raportin mbi “Indeksin e transparencës së autoriteteve qendrore dhe të varësisë 2021”, të publikuar gjatë muajit janar.

Nga monitorimi dhe analiza e situatës, Zyra e Komisionerit vlerëson se kërkohet një dinamikë e re në përmbushjen e detyrave nga koordinatorët apo rritjen e cilësisë së procesit të trajtimit në kohë dhe në objekt të kërkesave për informacion të qytetarëve dhe grupeve të interesit. Njëkohësisht, vëmendje e shtuar duhet t'i kushtohet përditësimit periodik të Programit të Transparençës dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, duke qenë se përbëjnë nga burimet kryesore për marrjen e dokumentacionit me karakter publik. Në këtë kontekst, informacionet rreth përmbajtjes së shpenzimeve buxhetore, procedurave të prokurimit publik apo auditimeve ndikojnë drejtpërdrejtë në transparencën proaktive të Autoriteteve Publike, si dhe rrisin besueshmërinë dhe llogaridhënien e tyre për publikun.

Praktika e monitorimeve nga Zyra e Komisionerit për gjetjen dhe adresimin e problematikave kanë për qëllim të forcojnë kulturën e ndërgjegjësimit të qytetarëve për ushtrimin e të drejtës së tyre, si dhe të nxisin Autoritetet Publike të çdo kategorie për respektimin e dispozitave ligjore.

Takimi i parë i Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit

Në cilësinë e anëtares së Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC), Zyra e Komisionerit mori pjesë në takimin e parë të tij, i cili u zhvillua online në datën 17 shkurt 2022. Ky Komitet drejtohet nga autoriteti Meksikan për të Drejtën e Informimit dhe përbëhet nga përfaqësues të vendeve si, SHBA-të, Shqipëria, Brazili, Bermuda, Afrika e Jugut dhe Kenia. Në këtë takim u trajtuan çështje të ndryshme dhe u ra dakord për ngritjen e një grupi pune për planifikimin e edicionit të 13-të të Konferencës, lancimin e thirrjes së aplikimeve për përzgjedhjen e organizatorit të edicionit të 14-të dhe 15-të të ICIC.

Takim i Komitetit të Planifikimit të Konferencës së 13-të ICIC

Zyra e Komisionerit është bërë pjesë e grupit për planifikimin e Konferencës së 13-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, ku ka marrë pjesë në takimin e tij të parë që u zhvillua online në datën 25 shkurt 2022. Ky Komitet drejtohet nga organizatori i ardhshëm i Konferencës autoriteti meksikan INAI dhe përbëhet nga anëtarë të tjerë si Shqipëria, Afrika e Jugut dhe Kenia. Përfaqësuesit e Zyrës së Komisionerit kanë dhënë kontributin e tyre sa i përket temës së përgjithshme për edicionin e 13-të që do të zhvillohet në Meksikë, si edhe janë diskutuar çështje të tjera lidhur me temat, përcaktimi i datave të aktivitetit dhe aspekte të ndryshme organizative.

SAVE THE DATE

June 22-24, 2022

Access to Information, participation
& inclusion in the Digital Age



Host

